

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. B. nga fshati P. Komuna e P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhje e pylli nga neni 358 par.2 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzave : PP.nr.4956/2012 dt.14.09.2012, PP.nr.5730/12 e dt.16.10.2012, PP.nr.5744/12 e dt.17.10.2012, PP.nr.5747/12 e dt.04.10.2012, PP.nr.6561/12 e dt.18.10.2012, PP.nr.6568/12 e dt.23.11.2012, PP.nr.6636/12 e dt.11.12.2012, PP.nr.3274/14 e dt.06.07.2012, PP.nr.4007/12 e dt.12.09.2012, PP.nr.4923/12, PP.nr.4964/12 e dt.22.08.2012, PP.nr.7856/11 e dt.26.04.2012, PP.nr.6542/11 e dt.09.11.2011, PP.nr.7629/1012 e dt.03.12.2012, PP.nr.8332/12 e dt.14.12.2012, PP.nr.4995/12 e dt.12.09.2012, PP.nr.4987/12 e dt.21.08.2012, PP.II.nr.4428/13 e dt.15.07.2013, PP.II.nr.4405/2013 e dt.16.07.2013, PP.II.nr.5350/13 e dt.02.09.2013, PP.II.nr.4418/13 e dt.18.09.2013, PP.II.nr.6096/13 e dt.19.09.2013, PP.II.nr.6108/13 e dt.29.10.2013, PP.II.nr.3709/13 e dt.01.11.2013, PP.II.nr.5828/15 e dt.06.11.2015, PP.II.nr.7168/15 e dt.17.12.2015, PP.II.nr.7184/15 e dt.16.12.2015, PP.II.nr.7185/15 e dt.22.01.2016, të PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 18.04.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci dhe të akuzuarit, me datë 20.04.2016, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 28.04.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

F. B., me nofken- L., nga i ati A. dhe nëna N. e vajzërisë J., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin P. ku edhe jeton me numri i tij personal i identifikimit- *numër personal...*,ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike- rast social, martuar, baba i 2 (dy) fëmijëve, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepra të njëjta penale, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera për vepra të njëjta penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me datën 12.08.2011, rreth orës 17:00, me qëllim të vjedhjes në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës-Drejtoria Koordinuese e APK-zyra në Podujevë, në vendin e quajtur "Rrezja e Madhe" të Regjionit Ekonomiko Pyjor në fshatin Sylevicë, KK Podujevë, ka prerë 20 copë trungje të llojit Bungu, me diametër 24-28 cm, me lartësi 16m, dhe vëllim të përgjithshëm 5,56m³, me ç` rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës-zyra në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 15.09.2011,rreth orës 13:30, në pyllin publik të quajtur "Hija e Madhe" Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Sylevicës, Komuna e Podujevës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit pasi i kishte prerë me sharrë motorike 34 copë trungje të llojit ahu, me dimensione të gjata 14-16cm, me diametër 14-20cm, e vëllim të përgjithshëm prej 3,44m³, me

ç`rast të dëmtuarës Drejtoratit të Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë , i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 25.09.2011, rreth orës 16:20, në pyllin publik të quajtur "Hija e Madhe" Regjioni Ekonomiko-pyJOR i Sylevicës, Komuna e Podujevës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit pasi i kishte prerë me sharrë motorike 27 copë trungje të llojit ahu, me dimension : të gjata 16m, me diametër 15-24cm, e vëllim të përgjithshëm prej 4,23m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtoratit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë, i ka shkaktuar dëmin dëm material.

Me datën 09.05.2012, rreth orës 16.20, në vendin e quajtur "Hija e Madhe" në Regjionin Ekonomiko-PyJOR të fshatit Sylevicë, KK Podujevë, në pyllin të cilin e administron Autoritetit Komunal në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë me sharrë motorike 50 copë trungje të llojit ahu, me dimensione të gjata 14-15m ,me diametër 15-17 cm, më vëllim të përgjithshëm prej 4.40m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit PyJOR Komunal në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 19.05.2012, rreth orës 14:00, me qëllim të vjedhjes , në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur "Bregu i Selimit" në Regjionin Ekonomiko-PyJOR të Sylevicës, ka prerë 12 copë trungje, të llojit ahu, të gjata 14m, me diametër 24-35cm, dhe me vëllim prej 3,70m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR të Kosovës, zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 19.06.2012, rreth orës 16:00, i pandehuri me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur "Rrezja e Madhe" në Regjionin Ekonomiko-PyJOR të Sylevicës, Komuna e Podujevës, me të cilin qeverisë Autoriteti PyJOR –zyra në Prishtinë, me sharrë motorike, me traktor të tipit "Ferguson" dhe ram, ka prerë 49 copë trungje të llojit Bungu, me gjatësi 14m, diametër 19:20cm, dhe vëllim të përgjithshëm prej 6.65m³, me ç`rast Autoritetit PyJOR të Kosovës, zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 23.06.2012, në ora 15:00, në pyllin publik të quajtur "Rrezja e Madhe" Regjioni Ekonomiko-PyJOR i "Sylevicës", Komuna e Podujevës, i pandehuri i lartcekur me qëllim vjedhje është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë dhe marrë me sharrë motorike, 21 copë trungje të llojit ahu, me dimensione të gjata 14-17m, me diametër 23-50cm, me vëllim të përgjithshëm, prej 4,93m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtoratit të Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 26.06.2012, rreth orës 14:10, në pyllin publik të quajtur "Hija e Madhe" në regjionin ekonomiko –pyJOR të Sylevicës, KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 31 copë trungje të llojit ahu, me sharrë motorike dhe traktor IMT 533, me dimensione 14 metra, diametër 20-21 cm, me vëllim të përgjithshëm 5,59m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë-Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 30.06.2012, rreth orës 17:15, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia pyjore e Kosovës-zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur "Hija e Madhe" Regjioni Ekonomiko PyJOR "Sylevicë" Komuna e Podujevës, ka prerë dhe marrë 26 copë trungje, dru të

llojit ah, me gjatësi 14m,diametër 28-31cm,dhe vëllim të përgjithshëm 7.95m^3 , me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës-zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 04.07.2012, rreth orës 20:30, në regjionin ekonomikopyjor të Podujevës, në vendin e quajtur "Bregu i Selimit"-Podujevë, pa të drejtë ka prerë 24 copë trungje ah, me diametër 19-22cm,me gjatësi 14m,me vëllim të përgjithshëm $6,40\text{m}^3$,me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit pyjor të Kosovës-zyra në Prishtinë, i është shkaktuar dëm material.

Me datën 08.07.2012, rreth orës 14:00, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës z-zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur "Hija e Madhe" Regjioni Ekonomiko –Pyjor i Sylevicës, Komuna Podujevë, ka prerë dhe marrë 31 copë trungje, dru të llojit ah, me gjatësi 14m, me diametër 22-29cm,dhe me vëllim të përgjithshëm 7.13m^3 , me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës –zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm material,

Më datë 14.07.2012, rreth orës 15:00, në pyllin publik të quajtur "Hija e Madhe" në Regjionin Ekonomiko-Pyjor Sylevicë KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 29 copë trungje të llojit ah me sharrë motorike dhe traktor IMT 539, me dimensione 15 metra, diametër 27-28 cm, me vëllim të përgjithshëm $7,83\text{m}^3$, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Më datën 22.07.2012, rreth orës 17:00, në pyllin publik të quajtur "Hija e Madhe" në Regjionin Ekonomiko-Pyjor Sylevicë, KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 21 copë trungje të llojit ah me sharrë motorike dhe traktor IMT 539, me dimensione 14-15 metra, diametër 24-30cm, me vëllim të përgjithshëm, $7,55\text{m}^3$, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Më datë 23.07.2012, rreth orës 13:00,me qëllim vjedhje, në pyllin me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural, KK Podujevë, në vendin e quajtur "Hija e Madhe, Regjionin Ekonomiko –Pyjor, i Sylevicës, KK Podujevë", me sharrë motorike, ka prerë dhe marrë 39 copë dru ah me gjatësi 15m, me diametër 24-26 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 7.81m^3 ,me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë, i është shkaktuar dëm material.

Me datën 10.08.2012,rreth orës 12:00, me qëllim të vjedhjes , në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur "Rrezja e Madhe", Regjioni Ekonomiko-Pyjor "Sylevicë" Komuna Podujevë, ka prerë dhe marrë 70 copë trungje, dru të llojit bingu, me gjatësi 14m, diametër 15cm, dhe vëllim të përgjithshëm 5.60m^3 , me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës –zyra në Prishtinë , i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 21.08.2012, rreth orës 15:55min, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia pyjore e Kosovës, zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur "Rrezja e Madhe", Regjioni Ekonomiko-Pyjor "Sylevicë", Komuna Podujevë, ka prerë dhe marrë 28 copë trungje, dru të llojit bingu, me gjatësi 15m,diametër 20-25cm,dhe vëllim të përgjithshëm 6.32m^3 , me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës-zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 15.08.2012, rreth orës 15:00, në vendin e quajtur “Roga e Madhe”, Regjioni Ekonomiko-PyJOR i Sylevicës, K. Podujevë, me qëllim të vjedhjes ka prerë 40 copë trungje të drunjtëve të llojit bungu me diametër 27cm, me dimensione të gjata 15m, me vëllim të përgjithshëm prej 6.40m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR të Kosovës-zyra në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 01.09.2012, rreth orës 12:00, me qëllim vjedhje, në pyllin e Agjencisë Pyjore të Kosovës zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur “Hija e Madhe”, Regjioni Ekonomiko-PyJOR i Sylevicës K. Podujevë, ka prerë 34 copë dru të llojit ahu, me diametër 24-27cm, në largësi prej 15m, me vëllim të përgjithshëm 7.70m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR të Kosovës-zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 06.10.2012, rreth orës 17:20, me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur “Rrezja e Madhe”, Regjioni Ekonomiko-PyJOR i Sylevicës K. Podujevë, i pandehuri F. B. është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke i prerë me sharrë motorike 46 copë dru të llojit ahu, 15 m të gjata, me diametër 17-19cm, me vëllim të përgjithshëm 4.47m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR të Kosovës-zyra në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 21.10.2012, rreth orës 15:10, me qëllim vjedhje në pyllin në të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” regjioni Ekonomiko-PyJOR Pakashticë K. Podujevë, ka prerë dhe marrë dru të llojit ahu, në gjatësi prej 15m, me diametër prej 20-25cm, me vëllim të përgjithshëm 3.88m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR të Kosovës-zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 22.04.2013, rreth orës 16:30, i pandehuri me qëllim vjedhje, në pyllin me të cilin administron Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, KK Podujevë, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” Regjioni Ekonomiko-PyJOR, i Sylevicës, KK Podujevë, ka prerë dhe marrë 25 copë dru, të llojit ahu, të gjata 14-15m, me diametër 18-21cm, me vëllim prej 3.49m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Më datën 09.06.2013, rreth orës 18:30, në pyllin publik të quajtur “Hija e Madhe” në regjionin ekonomiko-pyJOR i Sylevicës KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja i pyllit duke prerë 10 copë trungje të llojit ahu, me traktor me ram dhe sharrë motorike, me dimensione 15 m, diametër 36cm, me vëllim të përgjithshëm 4,10m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.15.06.2013, rreth orës 18:00, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Agjencioni PyJOR i Kosovës, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” të regjionit Ekonomiko -PyJOR në Sylevicë, Komuna e Podujevës, i pandehuri ka prerë 18 copë trungje të llojit ahu, me gjatësi 17m, me diametër 23cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.42m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencioi PyJOR Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 27.06.2013, rreth orës 14:30, me qëllim të vjedhjes në pyll me të cilin qeverisë Agjencioni PyJOR i Kosovës, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” të Regjionit PyJOR në Sylevicë, K. Podujevë, i pandehuri ka prerë 13 copë trungje të llojit ahu, me gjatësi 15m, me diametër 22-40cm, me vëllim të përgjithshëm prej 4.08m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit PyJOR Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 24.07.2013, rreth orës 15:00, me qëllim të vjedhjes në pyll me të cilin qeverisë Agjencioni Pyjor i Kosovës, në vendin e quajtur “Rrezja e Madhe” të Regjionit ekonomik – Pyjor në Sylevicë K. Podujevë, i pandehuri ka prerë 19 copë trungje të llojit bungu, me gjatësi 15m, me diametër 24-31cm, me vëllim të përgjithshëm prej 5.60m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 28.07.2013, rreth orës 15:40, me qëllim të vjedhjes në pyllin me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-sektori i pylltarisë në vendin e quajtur “Hija e Madhe” Regjioni Ekonomiko- Pyjor të Sylevicës, ka kryer 33 copë trungje të llojit ahu, të gjata 14-15m, me diametër 17-19cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.98m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 23.08.2015, rreth orës 13:20, me qëllim për të vjedhur ka shkuar në pyll, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të Sylevicës, K. Podujevë, me të cilin menaxhon Komuna Podujevë, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sektori i pylltarisë ku aty ka prerë 38 copë trungje të llojit ahu, me diametër 17-21 cm, me gjatësi prej 13m, me vëllim të përgjithshëm 3.92m³, me ç`rast të dëmtuarës Komunës së Podujevë, sektorit të pylltarisë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 08.11.2015, rreth orës 14:50, me qëllim të vjedhjes në pyll me të cilin qeverisë regjioni ekonomik-pyjor i Sylevicës, në vendin e quajtur “Hija e Madhe”, i pandehuri ka prerë 67 copë dru të llojit ahu, me gjatësi 11-12m, me diametër 16-23cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6-40m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 09.11.2015, rreth orës 14:15, me qëllim të vjedhjes në pyllin me të cilin qeverisë Agjencioni Pyjor i Kosovës, në vendin e quajtur Hija e Madhe, në Regjionin Ekonomiko-Pyjor Sylevicës, KK Podujevë, ka prerë 65 copë trungje, të llojit Ahu, të gjata 10m, me diametër 18-24cm, dhe vëllim prej 4.77m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 19.11.2015, rreth orës 14:15, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, në vendin e quajtur “Hija e Madhe” në Regjionin Ekonomiko-Pyjor Sylevicës, KK Podujevë, ka prerë 41 copë trungje të llojit Ahu, të gjata 11m, me diametër 18-24cm, dhe vëllim prej 4.59m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,43,45,73, nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453, 463, të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin **F. (A.) B.**, me **dënim me burg** në kohëzgjatje **prej 5 (pesë) muaj**, të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **400 € (katërqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj në këste mujore në afat prej 3 (tre) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në këste mujore në afat prej 3 (tre) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është përfitues i ndihmës sociale.

E dëmtuara Agjensioni Pyjor i Kosovës zyra në Podujevë për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzat PP.nr.4956/2012 dt.14.09.2012, PP.nr.5730/12 e dt.16.10.2012, PP.nr.5744/12 e dt.17.10.2012, PP.nr.5747/12 e dt.04.10.2012, PP.nr.6561/12 e dt.18.10.2012, PP.nr.6568/12 e dt.23.11.2012, PP.nr.6636/12 e dt.11.12.2012, PP.nr.3274/14 e dt.06.07.2012, PP.nr.4007/12 e dt.12.09.2012, PP.nr.4923/12, PP.nr.4964/12 e dt.22.08.2012, PP.nr.7856/11 e dt.26.04.2012, PP.nr.6542/11 e dt.09.11.2011, PP.nr.7629/1012 e dt.03.12.2012, PP.nr.8332/12 e dt.14.12.2012, PP.nr.4995/12 e dt.12.09.2012, PP.nr.4987/12 e dt.21.08.2012, PP.II.nr.4428/13 e dt.15.07.2013, PP.II.nr.4405/2013 e dt.16.07.2013, PP.II.nr.5350/13 e dt.02.09.2013, PP.II.nr.4418/13 e dt.18.09.2013, PP.II.nr.6096/13 e dt.19.09.2013, PP.II.nr.6108/13 e dt.29.10.2013, PP.II.nr.3709/13 e dt.01.11.2013, PP.II.nr.5828/15 e dt.06.11.2015, PP.II.nr.7168/15 e dt.17.12.2015, PP.II.nr.7184/15 e dt.16.12.2015, PP.II.nr.7185/15 e dt.22.01.2016, kundër të akuzuarit F. B. nga fshati P. Komuna e P., për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.04.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci dhe të akuzuarit F.B..

Gjykata paraprakisht ka verifikuar të kaluarën kriminale për të akuzuarin e lartcekur dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të akuzuarit F.B. për lëndët: Pka.nr.314/12, Pka.nr.407/12, Pka.nr.408/12, Pka.nr.414/14, Pka.nr.419/12, Pka.nr.470/12, Pka.nr.511/12, Pka.nr.721/12, Pka.nr.954/12, Pka.nr.1234/12, Pka.nr.1240/12, Pka.nr.1241/12, Pka.nr.1246/12, Pka.nr.1599/12, Pka.nr.1655/12, Pka.nr.1708/12, Pka.nr.1751/12, Pka.nr.677/13, Pka.nr.705/13, Pka.nr.840/13, Pka.nr.849/13, Pka.nr.871/13, Pka.nr.994/13, Pka.nr.1041/13, Pka.nr.1054/15, Pka.nr.1282/15, Pka.nr.1283/15, Pka.nr.82/16, ashtu që çështja penale për gjithsejtë 28 (njëzet e tetë) lëndë do të bartë numrin më të vjetër **Pka.nr.314/12**.

Pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari F.B. deklaroi: e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzave, duke shtuar se i premtom gjykatës që në të ardhmen nuk do të merrem me këtë punë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë për shkak se është i gjendjes së rëndë ekonomike-rast social.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: pajtohem me pranimin e fajësisë ngase është bërë konform dispozitave të KPPRK-së, dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjeve që i përmbajnë aktakuzat në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të pranuar nga ia akuzuari dhe se aktakuzat nuk përmbajnë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në prova që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka zbatuar ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, ashtu që beri rikualifikimin e veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, në veprë të njëjtë penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, pasi që e dëmtuara është e njëjtë, objekti i veprës penale i njëjtë si dhe dashja e kryerësit, të parapara me nenin 81 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit F.B. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, nga se ka qenë i vetëdijshëm për veprimet tij dhe ka dashur kryerjen e veprës penale.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit lidhur me të akuzuarin F. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor i gjendjes së rëndë ekonomike-rast social, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, ka qenë i gjykuar me edhe më parë për vepra penale të njëjta, sipas aktgjykimeve dënuese me numra: P.nr.380/2012, PKa.nr.388/2012, P.nr.449/2012, P.nr.507/2012, P.nr.195/2013, P.nr.730/2013, P.nr.34/2014, P.nr.216/2014, P.nr.702/2014, P.nr.241/2014, P.nr.872/2011, P.nr.660/2012, P.nr.734/2012, P.nr.796/2012, P.nr.814/2012, P.nr.828/2012, P.nr.954/2012, P.nr.677/2013, P.nr.778/2013, të gjitha të formës së prerë, si dhe duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është prona publike, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbaj pasi aktgjykim të merr formën e prerë.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave

penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për lirim nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale është marr duke u bazuar në nenin nenit 453 par.4 të KPPRK-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe familjes së tij, pasi që i akuzuari është përfitues i ndihmës sociale bazuar në Kartelën e Ndhmës Sociale me nr.28577 të datës 16.06.2015.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetojë saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk parqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
Pka.nr.314/2012,dt.28.04.2016

Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.